

KUARTETI I CREMONA-S

Cristiano Gualco *violinë* **Paolo Andreoli** *violinë*
Simone Gramaglia *violë* **Giovanni Scaglione** *celo*

Që nga themelimi i tij në vitin 2000, Kuarteti i Cremona -s u afirmua si një nga realitetet e muzikës së dhomave më interesante në nivel ndërkombëtar dhe është ftuar rregullisht për të marrë pjesë në festivale muzikore në Evropë, Amerikën e Jugut, Shtetet e Bashkuara dhe Lindjen e Largët, duke fituar konsensusin unanimit të publikut dhe kritikës.

Shtypi i specializuar ndërkombëtar gjithmonë ka theksuar cilësitë e larta artistike dhe interpretative dhe stacionet radiotelevisive nga e gjithë bota (si RAI, WDR, BBC, VRT, SDR, ABC) transmetojnë rregullisht koncertet e tyre me një repertor që varion nga veprat më të hershme të Haydn deri te muzika bashkëkohore.

Në fushën diskografike, kohët e fundit ka përfunduar publikimin integral të Kuarteteve të Beethoven-it për Audite: tetë vëllimet kanë fituar çmime prestigjioze diskografike (duke përfshirë Echo Klassik 2017 dhe ICMA 2018) si dhe vlerësime të rëndësishme nga kritika ndërkombëtare, që në mënyrë unanime e konsiderojnë Kuartetin e Cremona-s trashëgimtarin e vërtetë të Kuartetit Italian. Në pranverën e vitit 2019 do të publikohet një album i ri dedikuar tërësisht Schubert -it, me pjesëmarrjen e Eckart Runge, themelues dhe violonçelist i Artemis Quartet.

Në sezonin 2017/18, Kuarteti i Cremona-s debutoi me sukses të madh në Amsterdam (Koncertgebouw, Muziekgebouw), Hamburg (Laeiszhalle), Edinburg dhe ka marrë pjesë në turne në Suedi dhe Danimarkë, në SHBA dhe Kanada dhe në Japoni, duke marrë miratimin unanimit të publikut. Ndër angazhimet më të rëndësishme të sezonit 2018/19, me siguri duhet të përmendim koncertet në Berlin (Konzerthaus), Hamburg (Elbphilharmonie), Stokholm, Gjenevë, Manchester, Amsterdam, Valencia, Nju Jork, Cartagena de Indias, Hong Kong përveç marrëdhënieve të konsoliduara me institucionet kryesore koncertore italiane.

Bashkëpunime të shumta me artistë të nivelit të lartë si Lawrence Dutton, Eckart Runge, David Orlovsky, Andrea Lucchesini, Edicson Ruiz, Aaron Pilsan, Quartetto Emerson.

Nga vjeshta e vitit 2011, Kuarteti i Cremona-s është titullar i katedrës së "Kursit të Specializimit të Lartë për Kuartet Harqesh" në Akademinë Walter Stauffer të Cremona –s dhe ftohet rregullisht të mbajë masterclass në Evropë, SHBA dhe Amerikën e Jugut.

Kuarteti i Cremona-s është mbështetur nga Kulturfonds Peter Eckes i cili u ka besuar atyre katër instrumente të jashtëzakonshme të liuterisë italiane:

Cristiano Gualco – violinë G. Battista Guadagnini “Cremonensis”, Torino 1767
Paolo Andreoli – violinë Paolo Antonio Testore, Milano ca. 1758
Simone Gramaglia – violë Gioachino Torazzi, ca. 1680
Giovanni Scaglione – violoncel Dom Nicola Amati, Bologna 1712

Gjithashtu, ansambli është dëshmi e projektit ndërkombëtar "Miqtë e Stradivarit" dhe e Thomastik Infeld Strings.

Në nëntor të vitit 2015, Kuarteti u nderua me Çmimin Qytetar Nderi i Qytetit të Cremona-s.